

Çka janë vendbanimet joformale?

Vendbanimet Joformale (VJF) janë vendbanime njerëzore që nuk i mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përhershëm të jetesës, sidomos banimin e përshtatshëm.

Me çka karakterizohen vendbanimet joformale?


Karakteristikat e vendbanimeve joformale janë:

1. Zotërim joformal ose i pasigurtë i pronësisë;
2. Qasje e papërshtatshme ose mungesë e qasjes ndaj shërbimeve themelore;
3. Pjesëmarrje joadekuate ose mungesë e pjesëmarrjes në qeverisje;
4. Ndjeshmëri deri në diskriminim.

Cilat janë vendbanimet joformale në Gjakovë?

Në qytetin e Gjakovës bazuar në karakteristikat e Vendbanimeve Joformale janë identifikuar si prioritare këto tri lagje:

1. Lagjja "Brekoc"
2. Lagjja "Kolonija"
3. Lagjja "Piskota-Dardanija".



PUNËTORIA E MBESHTETUR NGA
KUVENDI I KOMUNËS
ASOCIACIONI I KOKOMUNAVE TË KOSOVËS
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
OSBE DHE UN-HABITATI



KUVENDI I KOMUNËS GJAKOVË



ORGANIZON

Fushë Punëtori mbi Vendbanimet
joformale në Gjakovë

Gjakovë
26 Prill 2007



1. Vendbanimi JoFormal - Lagjja "Brekoc"

Vendbanimi i Brekocit është identifikuar si vendbanim joformal bazuar në kriteret për kategorizimin e VJF sipas Udhëzuesit të MMPH.

Karakteristikat e këtij VJF janë:

- Zotërim joformal ose jo i sigurt i pronësisë në 20% (joposedim dhe uzurpim);
- Qasje joadekuata në shërbimet elementare

Të dhëna relevante për Brekocin:

Lokacioni: pjesa jug-perëndimore, largësi 3.5km nga qendra

Sip: ~25ha

Banorë: ~650 banorë (75% janë RAE, 25% shqiptarë)

Dendësia: ~70b/ha.

Mosha e popullsisë: >50% të popullsisë janë të moshës 18-65 vj
Punësimi: vetëm 25% janë të punësuar (sipas hulumtimit MMPH).

Lloji i banimit: Banim individual me P dhe P+1.

Nr i ngastrave: 177 ngastra.

Pronësia: pronë shoqërore, publike dhe pronë e Kuvendit të Komunes

2. Vendbanimi JoFormal - Lagja "Kolonia"

Lagja Kolonia si VJF shquhet me këto karakteristika:

- Zotërim joformal ose jo i sigurt i pronësisë në 20% (joposedim dhe uzurpim)
- Qasje joadekuata në të gjitha shërbimet elementare.
- Ndotje të ajrit sepse ndodhet shumë afër deponia komunale e mbeturinave si dhe me dendësi të madhe ndërtimi.

Të dhëna relevante për Lagjen Kolonia:

Lokacioni: pjesa lindore e qytetit

Sip: ~10.61ha

Vjetërsia: 30vite

Banorë: 720 banorë (90% janë RAE, 20% shqiptarë)

Pronësia: pronësi publike, private, raste me pronë të joposeduar dhe raste të uzurpimit

Lloji i banimit: Banim Individual

Destinimi i tokës: tokë bujqësore (sipas PGJU)

Lloji i banimit: Banim Individual me P dhe P+1

3. Vendbanimi JoFormal - Lagjja "Piskota-Dardania"

Lagja Dardania si VJF shquhet me këto karakteristika:

- Zotërim joformal ose jo i sigurt i pronësisë
 - Rrezikim nga vërshimi i lumit Krena
 - Ka edhe ndotje të ajrit (afërsia afër fabrikës së tjegullave)
 - Qasje joadekuata në shërbimet elementare sidomos ujë (ujë mirret nga pusët dhe ka kualitet të dobët për shkak të afërsisë së lumit)
- Hrudat janë të ngushta, të paasfaltuara dhe të panevrikuara
megjithatë transporti publik nuk është në

Të dhëna relevante për Lagjen Piskota- Dardania:

Lokacioni: pjesën veriore të qytetit

Vjetërsia: 20 vite

Sip: ~118 ha

Banorë: 30 banorë (70% RAE (romë dhe ashkali) dhe 30% shqiptarë)

Pronësia: pronësi publike, private, raste me pronë të joposeduar dhe raste të uzurpimit

Lloji i banimit: Banim Individual

Destinimi i tokës: ka qenë e paraparë si zonë industriale (sipas PGJU)

Lloji i banimit: Banim individual me P dhe P+1.

Çka është bërë në trajtimin e këtyre vendbanimeve joformale?

Deri tani, si rezultat i bashkëpunimit të Qeverisë së Gjakovës si partner kryesor i procesit me MMPH-së, CDF dhe studion 'Urban Plus' si partner implementues dhe komunitetit është punuar në trajtimin e Lagjes së Brekocit.

Të arriturat janë:

- Hartimi i PRrU (Planit Rregullues Urban) i VJF- Lagja e Brekocit si dhe përcaktimi i strategjisë për implementimin e planit;
- Sensibilizimi i komunitetit për VJF me qëllim të parandalimit dhe pengimit për krijimin e vendbanimeve të reja joformale;
- Organizimi / involvimi i komunitetit;
- Ndërtimi i qendrës së komunitetit;
- Bashkëpunimi ndërinstytucional;
- Eksperienca për trajtimin dhe rregullimin e vendbanimeve joformale dhe

Integrimi urban, social dhe ekonomik mbrenda strukturës së tërësishme të qytetit si dhe racionalizimi dhe inkorporimi i PRrU të VJF-Brekoc me Planin Zhvillimor Urban

Procesi i hartimit të PRrU për VJF- Lagjja "Brekoc"

Fazat në të cilat ka kaluar procesi i hartimit të PRrU

- Analiza e situatës Urbane
- Përcaktimi i kufinjëve përfshirës të VJF-Brekoc
- Hartimi i PRrU
- Shqyrtimi publik konform Ligjit për Planifikim Hapësinor, Udhëzuesit Administrativ për PRrU dhe atij për Procedurën e hapjes së Shqyrtimit publik
- Dorëzimi për miratimi dhe aprovim në Kuvendin e Komunës



A është përfshirë komuniteti në procesin e hartimit të PRrU?

Procesi i hartimit të PRrU për Brekocin ka qenë gjithpërfshirës dhe transparent. Gjatë konsultimeve urbane janë përfshirë të gjitha palët të cilat preken nga ky plan ose që mund të kenë ndikim në hartimin dhe implementimin e tij si: qytetarët-komuniteti duke involvuar edhe gjininë femrore si dhe fëmijët, institucionet, ndërmarrjet publike dhe private, OJQ-të etj.